



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2020:178515

Datë: 17.05.2024

Numri i dokumentit: 05700264

KPPP.nr. 572/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Arbër Rexha, në çështjen përbarimore të kreditorit “Telekomi i Kosovës”, Sh.A., me numër unik identifikues 811288001 dhe seli në Prishtinë, kundër debitorit NTSH “Kayalar” me numër unik identifikues 811304401 dhe pronar K.A.F., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Dren Salihu, avokat nga Prishtina, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër urdhrit përbarimor P.nr. 942/2020, të lejuar me datë 26.10.2020, nga Përbaruesi Privat Emine Sherifi-Lubeniqi, pas mbajtjes së seancës publike dëgjimore për shqyrtimin e validitetit të prapësimin të debitorit të datës 17.05.2024, në të njejtën ditë, mori këtë:

A K T V E N D I M

PËRFUNDOHET procedura e përbarimit sipas Urdhrit Përbarimor P.nr. 942/2020, të lejuar me datë 26.10.2020, nga Përbaruesi Privat Emine Sherifi-Lubeniqi, në çështjen përbarimore të kreditorit “Telekomi i Kosovës” Sh.A., me numër unik identifikues 811288001, ndaj debitorit “Kayalar” me numër unik identifikues 811304401 dhe pronar K.A.F..

A r s y e t i m

Përbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “Telekomi i Kosovës” Sh.A., mbi bazën e dokumenteve të besueshme, Faturës nr. 185176, e datës 30.06.2018; Faturës nr. 185182, e datës 30.06.2018; Faturës nr. 185707, e datës 31.07.2018; Faturës nr. 186268, e datës 31.08.2018; Faturës nr. 186275, e datës 31.08.2018; Faturës nr. 187981, e datës 30.11.2018; Faturës nr. 188497, e datës 31.12.2018; Faturës nr. 189177, e datës 31.01.2019; Faturës nr. 189783, e datës 28.02.2019; Faturës nr. 190396, e datës 31.03.2019; Faturës nr. 190967, e datës 30.04.2019; Faturës nr. 191640, e datës 31.05.2019; Faturës nr. 192255, e datës 30.06.2019; Faturës nr. 192260, e datës 30.06.2019; Faturës nr. 193069, e datës 31.07.2019; Faturës nr.

193731, e datës 31.08.2019; Faturës nr. 195110, e datës 31.10.2019; Faturës nr. 195767, e datës 30.11.2019; Faturës nr. 196453, e datës 31.12.2019; Faturës nr. 196942, e datës 31.01.2020; Faturës nr. 197705, e datës 29.02.2020; Faturës nr. 198285, e datës 31.03.2020; Faturës nr. 198752, e datës 30.04.2020; Faturës nr. 198753, e datës 30.04.2020; Faturës nr. 199196, e datës 31.05.2020; Faturës nr. 199709, e datës 30.06.2020, si dhe; Faturës nr. 199710, e datës 30.06.2020, ka lejuar Urdhrin Përmbarrimor P.nr. 942/2020, të datës 26.10.2020, me të cilin është urdhëruar debitori NTSH “Kayalar” me pronar K.A.F., që, brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e pranimit të urdhrit, kreditorit t’ia paguaj shumën e përgjithshme prej EUR 103,262.68, me kamatëvonesë prej 8% duke filluar nga data kur kredia është bërë e arritshme e deri në pagesën definitive, si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përmbarrimore.

Ndaj këtij urdhri përmbarrimor, debitori ka paraqitur prapësim me të cilin e ka kundërshtuar në tërësi si të pabazuar urdhrin mbi lejimin e përmbarrimit, me arsyetim se kreditori kishte probleme në ofrimin e shërbimeve për ‘Bulk SMS’, probleme të cilat debitori i kishte paraqitur me shkrim pranë kreditorit. Ndërsa, ka shtuar se debitori nuk e konteston bazën ligjore të obligimit por lartësinë e borxhit i cili do të duhej të ishte 40% më i vogël se sa pretendimi i kreditorit për shkak se në ofrimin e shërbimeve ka pasur probleme teknike. Në fund, gjykatës i ka propozuar që prapësimin e debitorit ta aprovoj si të bazuar, ashtu që urdhri përmbarrimor të shfuqizohet.

Kreditori, në përgjigje në prapësim ka theksuar se nga vet prapësimi i debitorit nuk mohohet ekzistimi i borxhit ndaj kreditorit por lartësia e tij për shkak të problemeve teknike, mirëpo ka shtuar se një pretendim i tillë i debitorit është i pabazuar, pasi që debitori për kundërshtime e debitorit në raport me shërbimet ka lëshuar notë krediti duke e liruar debitorit nga shuma e 20% të vlerës së detyrimit ndaj kreditorit. Me tej, ka theksuar se asnjëra nga pretendimet e debitorit nuk paraqesin shkak në kuptim të nenit 71 të LPP-së, për anulimin e urdhrit përmbarrimor, ndërsa ka shtuar se dokumentet mbi bazën e së cilave është lejuar urdhri i përmbajnë të gjitha elementet e përcaktuara në nenin 29 të LPP-së. Prandaj, gjykatës i ka propozuar që prapësimin e debitorit ta refuzoj si të pabazuar, ndërsa urdhri përmbarrimor të mbetet në fuqi.

Gjykata, me qëllim të shqyrtimit të validitetit të prapësimit të debitorit, me datë 17.05.2024, ka caktuar dhe mbajtur seancën dëgjimore në të cilën kanë prezantuar përfaqësuesit e palëve ndërgjyqëse.

Në seancën e mbajtur dëgjimore, kreditori ka theksuar se rasti përmbarrimor kundër debitorit është përfunduar në atë mënyrë që debitori ka përmbushur obligimet e tij të cilat i ka pasur duke

paguar detyrimin në tërësi sipas urdhrit përmbarimor, përfshi kamatat dhe shpenzimet e procedurës. Andaj, meqë debitori ka përmbushur detyrimin nda kreditorit, organi përmbarimor ka nxjerr konkluzionin P.nr. 942/20, të datës 22.03.2021, me të cilin është konstatuar se procedura në këtë çështje është përfunduar për shkak të përmbushjes.

Përfaqësuesi i autorizuar i debitorit, në seancën e mbajtur dëgjimore, ka konfirmuar deklaratimet e kreditorit duke shtuar se të gjitha obligimet sipas këtij urdhri janë përmbushur nga ana e debitorit. Kreditori gjithashtu gjatë seancës së cekur më lartë e ka konfirmuar se Debitori në tërësi e ka përmbushur detyrimin që rrjedhë nga faturat lëndore.

Gjykata, pasi shqyrtimit të pretendimeve të palëve, shkresat e lëndës, si dhe vlerësimit të Konkluzionit të lëshuar nga Përmbaruesi Privat P.nr. 942/20, të datës 22.03.2021, gjeti se debitori ka përmbushur në tërësi detyrimin ndaj kreditorit, duke përfshi edhe kamatëvonesat dhe shpenzimet e procedurës. Prandaj, në kuptim të dispozitave nga neni 66.4 të LPP-së, me të cilën përcaktohet se: *“Pas përmbushjes së kredisë së kreditorit nxirret vendimi për përfundimin e procedurës përmbarimore”*, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi duke përfunduar procedurën përmbarimore sipas Urdhrit Përmbarimor P.nr. 942/2020, të datës 26.10.2020, për shkak të përmbushjes së detyrimit nga ana e debitorit.

Nga sa më sipër, në mbështetje të nenit 66.4 të LPP-së, dhe nenit 13, pika 1.1 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 572/22, datë 17.05.2024

Gjyqtari
Arbër Rexha

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale, në Prishtinë, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.